



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPSHINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS

IZLAZNI - DALËSE
02/Br Prot. 01-030/01-5266/20
M. Prot. 16
Datum 15.06.2020
ŠTRPCE - SHTËRPCË

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE (KAB) e KOMUNËS SË SHTËRPCËS 2021-2023

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



Nga: z. Bratislav Nikolić, Kryetari Komunës së Shtërpçës

Për: z. Predrag Grbić, Kryesuesi Kuvendit Komunal, Komuna e Shtërpçës

Lënda: Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB), 2021-2023 e Komunës së Shtërpçës

Datë: 15.06.2020

I nderuari Kryesues i Kuvendit,

Kemi kënaqësinë t'ju dorëzojmë Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023 të Komunës së Shtërpçës në të cilin janë të prezantuara vendimet komunale lidhur me caqet e përgjithshme të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe mënyrën se si është bërë ndarja në mes kategorive kryesore ekonomike sipas kufijve fillestar në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2021/01.

Përgatitja e vlerësimit e hershme 2021 për secilin program është udhëhequr nga secili drejtor i drejtorisë/programit në bazë të vlerësimit të saktë të kostos së programeve dhe aktiviteteve të aktuale.

Gjatë procesit të hartimit të dokumentit KAB (2021-2023) të Komunës së Shtërpçës janë përfshirë edhe propozimet nga takimi me publikun dhe konsultimet me komunitetin.

Nga Ju, i nderuar Kryesues i Asamblesë Komunale, kërkohet të përcjellni KAB (2021-2023) të Komunës së Shtërpçës më tutje në shqyrtim dhe miratim sipas afateve të përcaktuara me Qarkoren Buxhetore 2021/01. Lëshuar nga Ministria e Financave.

Kryetari i Komunës z. Bratislav Nikolic

Përmbajtja

1. HYRJE	3
2. TË DHËNAT THEMLORE TË KOMUNËS.....	4
3. DEKLARATA E KOMUNËS NË LIDHJE ME PRIORITETET STRATEGJIKË ZHVILLIMORE	4
4. KORNIZA FISKALE KOMUNALE.....	5
4.1. TENDENCA E TË HYRAVE KOMUNALE DHE PARASHIKIMI AFATMËSËM 2021-2023.....	6
4.1.1. TENDENCA E TË HYRAVE KOMUNALE (2017-2019)	6
4.1.2. TË HYRAT KOMUNALE NË VITIN 2019 DHE PLANI PËR PERIUDHËN 2021-2023	6
4.1.3. DONATORËT E JASITËM (NDËRKOMBËTARË)	10
4.1.4. POLITIKAT E REJA	10
4.2. TENDENCA E SHPENZIMEVE	10
4.2.1. PAGAT DHE MEDIJT	11
4.2.2. MALLRAT DHE SHËRBIMET	11
4.2.3. KOMUNALITË.....	11
4.2.4. SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	11
4.2.5. SHPENZIMET KAPITALE.....	11
5. TABELA E KORNIZËS BUXHETORE KOMUNALE.....	12
6. KORNIZA E PERFORMANCËS SË SHPENZIMEVE	15

1. Hyrje


Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitin 2021 deri 2023 në përputhje me Qarkoren Buxhetore për Komuna nr. 2021/01 dhe Ligjit nr 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Financiare, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-211, duhet të përmbajë kornizën fiskale të Komunës për periudhën e ardhshme trevjeçare. Korniza Afatmesme e Buxhetore shërben si dokument kryesor ndërlidhës i planifikimit të politikave të komunës me planin e shpenzimeve dhe si e tillë paraqet komponentë të rëndësishme të procesit të përgjithshëm buxhetor.

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e prezantuar në vazhdim të këtij dokumenti në parim miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Dokumenti siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB siguron mekanizmat e nevojshëm përmes së cilave objektivat prioritare të identifikuara në dokumentet strategjike të Komunës, për të integruar sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuara nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2021/01 e pranuar nga Ministria e Financave.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritar të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2021-2023.

Figura 1: Procesi i Përgatitjes së KAB Komunale



2. Të dhënat themelore të komunës

Komuna e Shtërpçës, është e vendosur në zonën verilindore të Maleve të Sharrit, në pjesën e epërme të basenit të lumit Lepenc, e cila quhet edhe Lugina e Sirinikut. Kufijtë e komunës në pjesën më të madhe përputhen me kufijtë natyror të luginës së Sirinikut, e cila është e rrethuar me masivin malor të maleve të Sharrit dhe degëve të tij: malet Oshlak, Koxha Ballkan, Zar dhe Malet e Liqeneve. Komuna paraqet zonë malore me tërësi specifike të dhëmbëzuar dhe me shtrirje të lartësisë mbidetare e cila sillet nga 900 m në luginën e Lepencit deri në 2.500 m në majën më të lartë, Luboten. Masivet malore dominante përcaktojnë izolimin hapësinor të zonës kah veriu dhe jugu, gjersa me Grykën e Brodit është siguruar hapja kah Rrafshi i Kosovës, e përmes Prevallës edhe kah Lugina e Prizrenit.

Komuna e Shtërpçës mbulon një sipërfaqe prej 247 km² duke përfshirë qytetin dhe 16 fshatra. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë dhe ekonomive familjare dhe banesave (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2011), komuna e Shtërpçës ka një popullsi prej 6.949 banorë.

Komuna	Numri i Popullsisë	Urban	Rural	Meshkuj	Femra	Sërb	Shqiptarë
Shtërpçe	6.949	1265	5.684	3.554	3395	3148	3757

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Dhjetor 2012

Vërejtje: Regjistrimit të fundit të popullatës nuk ju kanë përgjigjur të gjithë banorët e komunës, ndërkohë sipas burimeve nga OSBE komuna ka 13.600 banorë: 9100 serb, 4.500 shqiptarë dhe 30 rom.

Numri i bizneseve private të regjistruara është mbi 600 në regjistrin e agjencisë për regjistrimin e bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa funksionale janë rreth 200.

3. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore do të shërbejë si bazë për zhvillimin e KAB 2021-2023 e cila pastaj do të shërbejë në procesin e rregullt buxhetor për vitin 2021 në kuadër të komunës dhe në përgatitjen e planit të punës për vitin 2021.

Vizioni dhe prioriteti i komunës të prezantuar në vijim të këtij dokumenti janë definuar pas konsultimeve me akterë të rëndësishëm të jetës politike, ekonomike e sociale në komunë në kuadër të aktiviteteve, seminareve dhe takimeve me ekspertë gjatë procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Planit Zhvillimor Urban (PZHU) dhe gjithashtu bazohet edhe në dokumentet afatgjata strategjike dhe afatmesme, të cilin e ka zhvilluar komuna, siç është Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qarkoret Buxhetore Komunale 2021-2023 (II) të lëshuar nga Ministria e Financave e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vizioni i Komunës së Shtërpçës:

Komuna e Shtërpçës do të jetë urë lidhëse, që lidh Kosovën me rajonin, komunë me turizëm, tregti, industri, bujqësi të zhvilluar të bazuar në traditë dhe rrjedhat moderne Komunë tërheqëse për investime në agrobiznes, turizëm reaktiv mjekësor dhe rekreacion

Edhe pse vizioni mund të tingëllojë si një ëndërr, Komuna e Shtërpçës me këtë vizion paraqet gjendjen të cilën dëshiron ta shoh në aspektin afatgjatë, kështu që duhet të jetë realist në lidhje me kërkesën për atë që komuniteti mund të arrijë brenda afatit të paraparë. Është e rëndësishme që prioritetet e orientuara të vizionit të lidhen me burimet e disponueshme të fondeve. Prioritete strategjike të komunës gjithashtu janë zhvilluar në dialog të ngushtë me grupet e synuara në komunitet. Më poshtë janë prezantuar fushat kryesore prioritare që mund të shërbejnë si fusha orientuese për zhvillim të mëtejshëm. Prioritetet strategjike të Komunës në periudhën afatmesme janë grupuar në katër fushat prioritare siç janë: Zhvillimi Ekonomik Lokal, Administrata Komunale, Shëndetësia dhe Arsimi që do të mundësojnë orientimin e veprimeve drejt realizimit të vizionit tonë për Komunën. Veprimet që planifikohen të ndërmerren gjatë periudhës afatmesme 2021-2023 do të jenë në harmoni me prioritetet e listuara më poshtë.

- 1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**
 - 1.1. Zhvillimi, promovimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës lokale;
 - 1.2. Zgjerimi të infrastrukturës rrugore;
 - 1.3. Shtirjes së rrjeteve të kanalizimit dhe ujësjellësit
 - 1.4. Përkrahja e zhvillimit të biznesit dhe iniciativave të ndërmarrësve të rinj;
 - 1.5. Zhvillimi i turizmit;
- 2. Përmirësimi i shërbimeve publike për qytetarët duke mundësuar:**
 - 2.1. Qasjen më të afërt dhe të lehtë në shërbimet publike të ofruara nga qeveria komunale
- 3. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe krijimi i mjedisit të qëndrueshëm të jetës përmes:**
 - 3.1. Ngritjes së efikasitetit dhe kualitetit të shërbimeve të Qendrave të Mjekësisë Familjare;
 - 3.2. Funksionalizimit të spitalit deri në fund të vitit 2021 ose në fillim të vitit 2022
 - 3.3. Përmirësimit të standardeve të mjedisit
- 4. Rritja e cilësisë në sferën e arsimit dhe kulturës**
 - 4.1. Rritjen e cilësisë në sferën e arsimit
 - 4.2. Promovimin e projekteve për rini, sport dhe kulturë
 - 4.3. Përmirësimi dhe avancimi i kooperimit ndëretnik

Prioritetet strategjike të komunës për periudhën afatmesme 2021-2023 do të shoqërohen me një përzjerje të hyrash dhe shpenzimesh kapitale të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

4. Korniza Fiskale Komunale

Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Numri i bizneseve private të regjistruara është mbi 600 në regjistrin e agjencisë për regjistrimin e bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa funksionale janë rreth 200.

Komuna nga ana e saj do të aprovon legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të saj, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale. Aktualisht financimi komunal mbi të cilën bazohet kjo kornizë fiskale komunale përfshinë:

- 1. Grantet Qeveritare**
 - 1.1. Granti i Përgjithshëm
 - 1.2. Granti Specifik për Arsimin Parauniversitar

- 1.3. Granti Specifik i Shëndetësisë
 - 1.3.1. Primare
 - 1.3.2. Sekondare
2. Të hyrat Vetanake Komunale
 - 2.1. Tatimi në Pronë
 - 2.2. Të hyrat tjera (Tarifat dhe Ngarkesat Komunale)
 - 2.3.

4.1. Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimi afatmesëm 2021-2023

4.1.1. Trendët e


4.1.2. të hyrave komunale (2017-2019)

Nga të dhënat historike të Hyrave Komunale (Grantet Qeveritare dhe) të Komunës së Shtërpçës, trendi i të hyrave komunale, kryesisht në periudhën 2017-2019 është në rritje si rezultat i stabilitetit politik të krijuar në komunë në zgjedhjet komunale në vitin 2009.

4.1.3. Të hyrat Komunale në vitin 2020 dhe plani për periudhën 2021-2023

Nga të dhënat e paraqitura (shiko Grafikun 2). Të hyrave komunale (viti aktual 2020 dhe planifikimi (2021-2023) i Komunës së Shtërpçës, pati një rënie në Grantet e Qeverisë 4,221,098 € (aktualisht) në 3,763,452 € (në vitin 2021). Këto ndryshime negative lajmërohen të granti specifik i arsimit dhe të granti i përgjithshëm. Grantet specifike për shëndetësi primare dhe sekondare kanë mbetur të njëjta si në vitin aktual, dhe të hyrat vetanake mbeten të njëjta në krahasim me vitin aktual.

Figura 1: Të hyrat Komunale për vitin 2020 dhe plani për periudhën 2021-2023



Ndërkohë, të hyrat vetanake (aktuale) dhe planifikimi për vitet (2021-2023) kanë mbetur të njëjta për dy vjet, 489,205.00 (viti 2020) dhe 489,205.00 (viti 2021), ndërsa për 2022 dhe 2023 ka një rritje të konsiderueshme. Kjo rritje është përqendruar kryesisht në të hyrat nga tatimi në pronë. Zbatimi i taksave për pronarët e makinave vazhdon.

Figura 1: Përbërja dhe niveli i të hyrave vetanake sipas vitit për periudhën 2017-2023




Tabela 1: Financimi nga të hyrat vetanake sipas burimit për periudhën 2017-2019

	KOMUNA E SHËRPECËS	Të hyra vetanake – 2017	Të hyra vetanake – 2018	Të hyra vetanake – 2019
		në Euro	në Euro	në Euro
	Burimi i të hyrave			
1	Lejet komerciale dhe të biznesit	100.00	00.00	00.00
	Puna e shitoreve të mëdha dhe shërbimeve të tjera			
	Puna e kiosqeve, punkteve të vogla mobile	100.00	00.00	00.00
	Puna e bankave, shërbimeve të sigurimit dhe shërbimeve të tjera financiare			
2	Lejet për lojërat argëtuese, alkool, reklamim, shpallje, etj.			
	Puna me aparatet për lojërat e fatit dhe lojëra të ngjashme			
4	Lejet për shfrytëzimin e tokës dhe për ndërtim	46,402.26	92,327.52	63,567.80
	Lejet për ndërtim	46,402.26	92,327.52	63,567.80
5	Inspeksioni i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	32,949.00	36,366.00	40,701.50
	Përgatitja e planifikimit urban dhe inspeksionet që ndërlidhen me dimensionet e pronës	32,949.00	36,366.00	40,701.50
	Aktivitetet në terren që kanë të bëjnë me matjen e hapësirës			
6	Shërbimet e inspektimit shëndetësor dhe të sigurisë	15,718.80	420.00	100.00
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik			
	Inspektimi mjedisor	140.00	190.00	100.00
	Inspektim i ndërtesave, shërbimit kundër zjarrit dhe ndërtimeve	15,578.80	230.00	00.00
7	Shfrytëzimi i pronës komunale	00.00	00.00	00.00
	Ngarkesat për hapësirë në tregje ose në objekte të ngjashme	00.00	00.00	00.00
8	Pagesat në lidhje me automjetet	19,410.00	20,530.00	20,990.00
	Lejet për automjete			
	Parkimi në parking publik të pajisur me garazhe ose hapësira të tjera	00.00	00.00	00.00
	Regjistrimet e automjeteve	19,410.00	20,530.00	20,990.00
9	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	9,270.00	8,283.00	9,031.00
	Dokumentet – lindjes, vdekjes, martesës, shkurorëzimit etj.	9,270.00	7,798.00	9,029.00
	Të tjera	00.00	485.00	2.00
10	Tatimi në pronë	104,311.64	137,670.15	182,611.79
	Pagesat e tatimit në pronë	104,311.64	137,670.15	182,611.79
11	Të hyra të tjera			
	Pagesa të tjera			
I-A.	Subtotali I-A , Të hyra direkte (Taksa dhe pagesa)	228,161.70	295,596.67	317,002.09
	Gjobat e trafikut të mbledhura nga Niveli Qendror (SHPK)	11,320.00	23,040.00	41,176.00
	Gjobat e gjykatës	2,010.00	6,855.00	3,970.00
	Të hyrat nga pylltaria	5,441.05	6,358.98	16,584.44
I- B.	Sub-totali I-B , Të hyra indirekte (pjesa që i përket komunave)	18,771.05	36,253.98	61,730.44
I	Gjithsej nga Administrata Komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	246,932.75	331,850.65	378,732.53
	TË HYRAT NGA ARSIMI			
	Çerdhet e fëmijëve			
	Mësimdhënia jo formale			
II	Gjithsej – Arsimi			
	TË HYRAT NGA SHËNDETËSIA			
1	Shëndetësia primare	397.10	834.75	1,159.90
2	Të tjera	120.00	80.00	20.00
III.	Gjithsej- Shëndetësia	517.10	914.75	1,179.90
Kod 21	TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III):	247,449.85	332,765.40	379,912.43

Tabela nr.02 – Planifikimi i të hyrave vetanake komunale për periudhën 2020-2023.

	KOMUNA E SHTËRPCËS	Të hyra vetanake – 2020	Të hyra vetanake – 2021	Të hyra vetanake – 2022	Të hyra vetanake – 2023
		në Euro	në Euro	në Euro	në Euro
	Burimi i të hyrave				
1	Lejet komerciale dhe të biznesit	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
	Puna e shitoreve të mëdha dhe shërbimeve të tjera				
	Puna e kiosqeve, punkteve të vogla mobile	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
	Puna e bankave, shërbimeve të sigurimit dhe shërbimeve të tjera financiare				
2	Lejet për lojërat argëtuese, alkohol, reklamim, shpallje, etj.				
	Puna me aparatet për lojrat e fatit dhe lojra të ngjashme				
4	Lejet për shfrytëzimin e tokës dhe për ndërtim	60,024.00	20,024.00	57,447.00	57,446.00
	Lejet për ndërtim	60,024.00	20,024.00	57,447.00	57,446.00
5	Inspeksioni i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	44,000.00	14,750.00	44,000.00	44,000.00
	Përgatitja e planifikimit urban dhe inspeksionet që ndërlihdhen me dimensionet e pronës	44,000.00	14,750.00	44,000.00	44,000.00
	Aktivitetet në terren që kanë të bëjnë me matjen e hapësirës				
6	Shërbimet e inspektimit shëndetësor dhe të sigurisë				
	Inspektimi i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim publik				
	Inspektimi mjedisor				
	Inspektimi i ndërtesave, shërbimit kundër zjarrit dhe ndërtimeve				
7	Shfrytëzimi i pronës komunale	0.00	0.00	0.00	0.00
	Ngarkesat për hapsirë në tregje ose në objekte të ngjashme	0.00	0.00	0.00	0.00
8	Pagesat në lidhje me automjetet	22,000.00	22,000.00	22,000.00	22,000.00
	Lejet për automjete				
	Parkimi në parking publik të pajisur me garazhe ose hapësira të tjera	2,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00
	Regjistrimet e automjeteve	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
9	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	15,000.00	15,000.00	15,000.00	15,000.00
	Dokumentet – lindjes, vdekjes, martesës, shkurorëzimit etj.	12,000.00	12,000.00	12,000.00	12,000.00
	Të tjera	3,000.00	3,000.00	3,000.00	3,000.00
10	Tatimi në pronë	337,181.00	406,431.00	441,968.00	477,506.00
	Pagesat e tatimit në pronë the tokës	337,181.00	406,431.00	441,968.00	477,506.00
11	Të hyra të tjera	0.00	0.00	0.00	0.00
	Pagesa të tjera	0.00	0.00	0.00	0.00
I-A.	Subtotali I-A , Të hyra direkte (Taksa dhe pagesa)	480,205.00	480,205.00	582,415.00	617,952.00
	Gjobat e trafikut të mbledhura nga Niveli Qendror (SHPK)				
	Gjobat e gjykatës				
	Të hyrat nga pylltaria	8,000.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00
I-B.	Sub-totali I-B , Të hyra indirekte (pjesa që i përket komunave)	8,000.00	8,000.00	8,000.00	8,000.00
I	Gjithsej nga Administrata Komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB)	488,205.00	488,205.00	590,415.00	625,952.00
	TË HYRAT NGA ARSIMI				
	Çerdhet e fëmijëve				
	Mësimdhënia jo formale				
II	Gjithsej – Arsimi				
	TË HYRAT NGA SHËNDETËSIA	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
1	Shëndetësia primare	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
2	Të tjera				
III.	Gjithsej- Shëndetësia	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
kodi 21	TOTALI I TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III):	489,205.00	489,205.00	591,415.00	626,952.00

Të hyrat vetanake të Komunës së Shtërpçës për tri vitet e ardhshme përbëjnë përafërsisht 13.00% të buxhetit total të komunës.

4.1.4. Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë)

Gjatë vitit 2019, komuna ka pasur një donacion në lidhje me performancën e komunave dhe ato nga Demos dhe Side në vlerë prej 37,516,00 €.

Komuna nuk ka informacion mbi mbështetjen e donatorëve për periudhën 2021-2023.

4.1.4 Politikat e reja


Komuna e Shtërpçës po ballafaqohet me ulje të Grantit Qeveritar, për shkak të kriteriumeve ku merret parasysh numri i banorëve, pasi që 2013 (viti 2014 tranzitor) të dhënat nga regjistrimi i fundit i popullsisë gjatë vitit 2011 janë bërë zyrtare dhe numri i banorëve në komunën e Shtërpçës është dukshëm më i vogël në krahasim me buxhetin komunal i cili është ndarë deri në vitin 2013. Mirëpo, në regjistrimin e fundit në vitin 2011 nuk kanë marr pjesë një numër i dukshëm i banorëve të komunës së Shtërpçës, ku dëshmia e kësaj është zgjedhjet komunale të vitit 2013, ku rreth 9,000 votues me të drejtë vote kanë shkuar në qendrat e votimit në Komunën e Shtërpçës. Gjithashtu, bazuar në treguesit që përdoren për ndarjen e grantit të përgjithshëm në komuna, Komunës së Shtërpçës është ndaluar 2% e granteve të përgjithshme, sipas një kriteri për komunat ku popullsia shumicë përbëhet nga komunitetet pakicë në Kosovë.

Sa i përket të hyrave vetanake të komunës, periudha e ardhshme është koha për të gjetur mundësi dhe mënyra të reja për të rritur të hyrat vetanake, pasi që në të ardhmen të hyrat vetanake kanë një ndikim e më të rëndësishëm në Komunën e Shtërpçës. Një trendi pozitiv që ekziston në tatimin në pronë dhe në periudhën e ardhshme, kjo rritje duhet të vazhdojë dhe të përshpejtohet.

4.2. Trendët e Shpenzimeve

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave edhe këtë vit në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023 dhe në Qarkoren Buxhetore për Komuna 2020/01 ka theksuar përkushtimin për ruajtjen e stabilitetit fiskal dhe për mbështetjen e prioritetëve afatmesme. Këtë vit, Komunat edhe për periudhën e ardhshme do të kenë fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorisë ekonomike për periudhën 2021-2023, duke përfshirë kategorinë "Paga dhe Mëditje". Si rezultat i kësaj, Komuna e Shtërpçës prezanton këtë ndarje të shpenzimeve për vitin 2021 në mes të kategorive të lejuara buxhetore. Numri i të punësuarve mbetet në nivel të vitit të kaluar, kurse masa monetare për paga dhe mëditje për vitin 2021 përfshin përvojën e punës të punësuarve (prej 0,5 për vit pune).

Figura 3: Përbërja e Shpenzimeve Komunale të Planifikuara sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Në krahasim me vitin 2020, shpenzimet totale do të shënjon ulje, në krahasim me vitin 2020, ose nga 4,221,098 (në vitin 2020) në 3,763,452 (në 2021), dhe në krahasim me vlerësimet për 2022 dhe 2023 e shënojmë një rritje në 4,228,802 (në 2022) dhe 4,345,518 (në 2023). Kjo rritje vjen si rezultat i rritjes së grantit specifik e arsimit dhe shëndetësi primare.

4.2.1. Pagat dhe mëditjet

Vlerësimet për vitin 2021, tregojnë se krahasuar me vitin 2020, këtë kategori shoqëron një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin paraprak, për shkak të ligjit të ri për pagat e miratuar në vitin 2019.

4.2.2. Mallrat dhe shërbimet

Në kategorinë "Mallra dhe shërbime" në vitin 2021, e njëjta shumë mbetet, sepse këto shpenzimet janë mjaft reale dhe mundesojnë një stabilitet të qëndrueshëm fiskal për komunën.

4.2.3. Shërbime komunale

Kjo kategori mbetet identike, kur e krahasojmë vitin 2021 me vitin 2020.

4.2.4. Subvencione dhe transferime

Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar në 2021 pason një rënie përqindjes prej 2.20% në vitin 2020, në 1.20% në 2021. Gjatë vitit 2021 dhe 2022, e shënojmë një ulje në 1.06% (2022) dhe 1.04% (2023) të kjo kategori. Edhe sepse kjo kategori është në interes të qytetarëve të Komunës dhe një nga prioritetet, sepse fondet nga kjo kategori ndahen kryesisht për zhvillimin ekonomik, dmth. bujqësinë, për shkak të miratimit të ligji të ri për pagat, si dhe ulje në Grantin e Përgjithshëm, kjo kategori mbetet përafërsisht e njëjtë si në 2020.

4.2.5. Shpenzimet kapitale

Kjo kategori e shpenzimeve gjatë periudhës së projektuar 2021-2023 përfaqëson mesatarisht rreth 21% të shpenzimeve totale të buxhetit. Kjo kategori e shpenzimeve ka potencialin më të madh për zhvillimin ekonomik, ku parashikohen ndërhyrje të ndryshme në infrastrukturë, siç janë rrugët, uji, kanalizimi. Sigurisht, duke marrë parasysh që zhvillimi ekonomik lokal është një nga fushat me prioritet të komunës, këto shpenzimet do të vazhdojnë të jenë në funksion të krijimit të një ambienti të favorshëm për rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat.

Sidoqoftë, ndikimi më i madh i uljes së buxhetit do të vazhdojë si në vitet të paraprak në këtë kategori të shpenzimeve, për shkak të uljes së grantit bazë. Gjithashtu, Komuna do të duhet të gjejë një mënyrë për të rritur të rritur hyrat vetanake, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve, sepse në të ardhmen, të hyrat vetanake kanë një ndikim më të rëndësishëm, për shkak të zvogëlimit të granteve.

Tabela 4: Shpërndarja Fillestare e Shpenzimeve Komunale sipas Drejtorive dhe Kategorive Ekonomike 2021

	Nr. i Punëtorëve	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Komunal	Subvencione dhe Transfer	Shpenzime të Kapitale	Gjithsej
Zyra Kryetarit	13	127,419	20,000		9,000		156,419
Zyra Kuvendit		95,678	6,000				101,678
Administrata	24	133,733	99,643	18,000			251,376
Inspektimet	8	48,600	7,000				55,600
Buxhet dhe Financa	13	80,088	16,000				96,088
Shërb. Pub.MC&Emergj. ZKK	8	56,620	77,680	65,000			199,300
	2	16,573	2,000				18,573
Zhvillimi Ekonomik	20	114,440	12,000		35,000		161,440
Gjeod. Kad. & Pronësi	5	35,813	7,000				42,813
Urbanizëm	4	32,886	7,000			425,482	465,368
Shëndetësia-Administrata	3	25,458	7,000		1,000		33,458
Shëndetësia-QKMF	20	118,032	41,539	5,525		76,729	241,825
Shëndetësia-QPS	8	52,001	12,000	2,100			66,101
Shënd. Sekondare	120	361,368	48,744			112,259	522,371
Arsimi-Administrata	5	35,728	7,000				42,728
Arsimi Fillor	186	821,856	58,279			12,192	892,327
Arsimi Mesëm	80	390,961	20,845			4,181	415,987
Gjithsej	519	2,547,254	449,730	90,625	45,000	630,843	3,763,452

Tabela 5: Shpërndarja Fillestare e Shpenzimeve Komunale sipas Drejtorive dhe Kategorive Ekonomike 2022

	Nr. i Pu.	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Komunali	Subvenci one dhe Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	13	127,419	20,000		9,000		156,419
Zyra e Kuvendit		112,485	6,000				118,485
Administrata	24	133,733	99,643	21,000			254,376
Inspektimet	8	48,600	7,000				55,600
Buxhet dhe Financa	13	80,088	16,000				96,088
Shërb. Pub.MC&Em	8	56,620	47,680	60,000			164,300
ergj. ZKK	2	16,573	2,000				18,573
Zhvillimi Ekonomik	20	114,440	12,000		35,000		161,440
Gjeod. Kad. & Pronësi	5	35,813	6,000				41,813
Urbanizëm	4	32,886	6,000			613,349	652,235
Shëndetësia-Administrata	3	25,458	6,000		1,000		32,458
Shëndetësia-QKMF	20	118,032	41,539	6,525		272,157	438,253
Shëndetësia-QPS	8	52,001	12,000	2,100			66,101
Shënd. Sekondare	120	361,368	82,744			78,259	522,371
Arsimi-Administrata	5	35,728	6,000				41,728
Arsimi Fillor	186	883,471	64,012			13,118	960,601
Arsimi Mesëm	80	421,508	21,954			4,499	447,961
Gjithsej	519	2,656,223	456,572	89,625	45,000	981,382	4,228,802

Tabela 6: Shpërndarja Fillestare e Shpenzimeve Komunale sipas Drejtorive dhe Kategorive Ekonomike 2023

	Nr. i Pu.	Paga dhe Mëditje	Mallra dhe Shërbime	Komunali	Subvencio ne dhe Transfere	Shpenzi me Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	13	156,180	20,000		9,000		185,180
Zyra e Kuvendit		145,678	6,000				151,678
Administrata	24	153,733	99,643	21,000			274,376
Inspektimet	8	48,600	7,000				55,600
Buxhet dhe Financa	13	100,088	16,000				116,088
Shërb. Pub.MC&Em ergj. ZKK'	8	56,620	47,680	60,000			164,300
	2	16,573	2,000				18,573
Zhvillimi Ekonomik	20	124,440	12,000		35,000		171,440
Gjeod. Kad. & Pronësi Urbanizëm	5	35,813	6,000				41,813
	4	32,886	6,000			610,464	649,350
Shëndetësia- Administrata	3	25,458	6,000		1,000		32,458
Shëndetësia- QKMF	20	118,032	41,539	5,525		274,343	439,439
Shëndetësia- QPS	8	52,001	12,000	2,100			66,101
Shënd. Sekondare	120	361,368	82,744			78,259	522,371
Arsimi- Administrata	5	35,728	6,000				41,728
Arsimi Fillor	186	887,447	64,300			13,268	965,015
Arsimi Mesem	80	423,405	22,053			4,550	450,008
Gjithsej	519	2,774,050	456,959	88,625	45,000	980,884	4,345,518

5. Tabela e Kornizës Buxhetore Komunale

	Pershkrimi	2020 Buxheti aktual	2021 (Plani)	2022 (Vlerësim)	2023 (Vlerësim)
1.	Të hyrat totale komunale	4,221,098	3,763,452	4,228,802	4,345,518
1.1	Të hyrat vetanake	489,205	489,205	591,415	626,952
1.2	Grantet dhe transferet qeveritare	3,731,893	3,274,247	3,637,387	3,718,566
1.3	Financimi nga Huamarrja	0,00	0,00	0,00	0,00
2.	Shpenzimet totale komunale				
2.1	Shpenzimet rrjedhëse	3,274,774	3,132,609	3,247,420	3,364,634
	Pagat dhe mëditjet	2,183,946	2,547,254	2,656,223	2,774,050
	Mallrat dhe shërbimet	456,881	449,730	456,572	456,959
	Subvencionet	45,000	45,000	45,000	45,000
	Komunalije	88,625	90,625	89,625	88,625
	Shpenzimet kapitale	946,324	630,843	981,382	980,884
	Rezrva	500,322			
3.	Bilanci primar buxhetor				
3.1	Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm	0,00	0,00	0,00	0,00
4.	Bilanci total buxhetor	0,00	0,00	0,00	0,00
5.	Financimi	0,00	0,00	0,00	0,00
5.1	Financimi i Jashtëm	0,00	0,00	0,00	0,00
	Ripagimi i borxhit kryesor	0,00	0,00	0,00	0,00
	Huamarrje e jashtme	0,00	0,00	0,00	0,00
5.2	Financim i brendshëm	0,00	0,00	0,00	0,00
	Shitja e aseteve	0,00	0,00	0,00	0,00
	Huamarrja brendshme	0,00	0,00	0,00	0,00
	Ndryshimi në fitimet e pashpërndara	0,00	0,00	0,00	0,00
6.	Bilanci bankar në fund të vitit	0,00	0,00	0,00	0,00

6. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

Kapitulli i Përfundimit të Shpenzimeve Komunale do të zhvillohet gjatë muajve në vazhdim dhe do të jetë përfundimtar pasi miratohet buxheti vjetor për vitin 2021 në Kuvend Komunal. Ky kapitull do të përfshijë treguesit e performancës për periudhën afatmesme 2021-2023 të cilët do të zhvillohen së bashku me drejtuesit kryesor e programeve komunal/ drejtorat të drejtorive